

Titulli i lëndës: Histori e Gazetarisë Shqiptare

Informatat themelore për lëndën		
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gazetarisë	
Titulli i lëndës:	Histori e Gazetarisë Shqiptare	
Niveli:	Bachelor	
Statusi i lëndës:	Obligative	
Viti i studimeve:	II/ semestri IV	
Numri i orëve në javë:	2+2	
Kreditë ECTS:	6	
Koha / Vendi:	Sipas orarit	
Mësimdhënësi:	Prof. Ass. Dr. Alban Zeneli	
Të dhënat kontaktuese:	alban.zeneli@uni-pr.edu	
Përshkrimi i lëndës:	Historia e Gazetarisë Shqiptare është një lëndë që synon të pajisë studentët me njohuri themelore dhe të strukturuar mbi zhvillimin e gazetarisë në hapësirën shqiptare, nga fillimet e saj deri në ditët e sotme. Përmes kësaj lënde, studentët do të njohin etapat kryesore historike, botimet më të rëndësishme, figurat themeluese dhe kontekstin politik, shoqëror e kulturor që ka ndikuar në formësimin e medias shqiptare. Kjo lëndë synon të forcojë vetëdijen profesionale të studentëve duke vënë në pah arritjet, vlerat, por edhe sfidat, vonesat dhe mungesat me të cilat është përballur gazetaria shqiptare gjatë historisë së saj. Në qendër të trajtimit janë roli i shtypit në formësimin e opinionit publik, ndikimi i regjimeve politike mbi lirinë e shprehjes dhe transformimet që ka përjetuar media në periudha të ndryshme, përfshirë kohën e Rilindjes Kombëtare, regjimin komunist dhe periudhën e tranzicionit demokratik. Kjo lëndë u jep studentëve një kuadër të domosdoshëm historik për të kuptuar zhvillimin e profesionit të gazetarit në Shqipëri dhe për të reflektuar mbi rolin e tij në shoqërinë shqiptare.	

Qëllimet e lëndës:				
Rezultatet e pritshme të nxënies:		Rezultatet e pritura të nxënies janë: Të njoh fillimet dhe zhvillimin dramatik të gazetarisë dhe ndikimin e saj në shoqëritë njerëzore. Njeh raportin ndërmjet gazetarisë dhe teknologjisë Mësojnë për raportin ndërmjet gazetarisë e drejtësisë dhe opinionit publik Motivohen për t'u bërë pjesë e asaj historie, bashkë me rritjen e ndjenjës së përgjegjësisë para komunitetit lexues dhe para historisë.		
		Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)		
Aktiviteti		Orë	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat		2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtime		2	15	30
Punë praktike		/	/	/
Përgatitje për test intermediar		/	/	/
Konsultime me mësimdhënësin		10 min	15	2.5
Puna në terren		/	/	/
Testi, punimi i seminarit		12	1	12
Detyrë shtëpie		2	15	30
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)		2	15	30
Përgatitja për provimin final		10	1	10
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)		3	2	6
Projektet, prezantimet, etj.		30 min	1	0.5
Total				151.5 orë= 6 ECTS

Metodat e mësimdhënies:	Metodologjia e mësimdhënies është e mbështetur para së gjithash në ligjërata në klasë dhe në ushtrime në klasë. Studentët që ndjekin këtë kurs kanë mundësi të ndjekin edhe ligjërata të gërshtuara me ushtrime, si dhe orë interaktive të diskutimeve për punimet e tyre të pavarura. Studentët marrin pikë vlerësuese që llogariten në ndërtimin e notës përfundimtare përmes detyrave në klasë dhe në shtëpi dhe përmes punës së pavarur në realizimin e shkrimeve. Këshillimet janë pjesë integrale e metodologjisë së mësimdhënies, sidomos në fazat kur studentët përgatisin punimet e tyre.			
Metodat e vlerësimit:		Pjesëmarrja korrekte në diskutime 0-10 % e notës përfundimtare Ushtrimet 0-20 % Testi 0-10% e notës përfundimtare Hulumtimi 0-10 % e notës përfundimtare Provimi me shkrim ose me gojë 50 % e notës përfundimtare		
Literatura primare:	1.Hamit Boriqi, Mark Marku, Historia e shtypit shqiptar 2.Blendi Fevziu, Histori e shtypit shqiptar 3. Luan Zelko, Mendimi shqiptar për gazetarinë 4. Artan Fuga, Monolog 5. Milazim Krasniqi, Ekskomunikimi			
	Orientuese: 1. Sami Frashëri, 1. Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e çd’do të bëhet, (mars) 2. Petro Marko, Retë dhe gurët (prill) 3. Milazim Krasniqi, Kosova pas 22 janarit 1998 (maj) 4. Artan Fuga, Brirët e dhisë (qershor)			

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjërates
Java 1:	PSE NDËR SHQIPTARË GAZETARIA LINDI ME VONESË TË MADHE (Pasojat kulturore të pushtimeve romake, bizantine, bullgare, serbe dhe osmane)

Java 2:	GAZETARIA SHQIPTARE NË PERIUDHËN E RILINDJES KOMBËTARE
Java 3:	Ndikimi i Lidhjes së Prizrenit në zhvillimin e mendimit shqiptar dhe të gazetarisë shqiptare
Java 4:	TIPARET E SHTYPI SHQIPTAR TË PERIUDHËS SË RILINDJES KOMBËTARE
Java 5:	Publicistika e Hoxha Tahsinit dhe Abdyl Frashërit
Java 6:	Publicistika e Pashko Vasës dhe Sami Frashërit
Java 7:	Publicistika e arbëreshëve të Italisë(titujt, tematika, konteskti kulturor)
Java 8:	SHTYPI NË KOSOVË NË KOHËN E RILINDJES KOMBËTARE
Java 9:	SHTYPI SHQIPTAR 1912- 1928
Java 10:	SHTYPI SHQIPTAR 1929-39
Java 11:	SHTYPI SHQIPTAR 1930- 1944
Java 12:	MEDIET SHQIPTARE NË SHQIPËRI VITET 1944- 1990
Java 13:	MEDIET SHQIPTARE NË ish JUGOSLLAVI NË 1944- 1990
Java 14:	SHTYPI SHQIPTAR NË PERIUDHËN E OKUPIMIT KLASIK 1990- 1999
Java 15:	MEDIET NË KOSOVË PAS VITIT 1999

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar të respektojnë normat themelore të sjelljes gjatë kohës së ligjëratave dhe ushtrimeve. Gjatë ushtrimeve studentët janë të obliguar të marrin pjesë aktive në mësim interaktiv. Atyre u mundësohet edhe prezantimi individual dhe grupor dhe qasja interaktive në mësim.